



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 1163/1 Prot.

Tiranë, më 22 . 08 . 2022

**V E N D I M**

**Nr. 170, Datë 22 . 08 . 2022**

Bazuar në nenin 32/1/c të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi duke marrë indicien nga informacioni<sup>1</sup> i marrë nga Qendra “Të Drejtat e Njeriut në Demokraci”, me Urdhërin nr. 14, datë 21.01.2021, filloi procedurën për ndjekjen kryesisht të çështjes, në lidhje me procedurën e aplikimit për përfitimin e ndihmës ekonomike, programet e tjera të mbrojtjes sociale si dhe shërbimet e ofruara nga zyrat e punësimit, nga ana e anëtarëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtimi i fakteve sipas subjektit, Qendra “Të drejtat e njeriut në demokraci”.**

Referuar shkresës së sjellë nga Qendra “Të drejtat e njeriut në demokraci”, (QDNJD) ndër të tjera informon se: “Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, QDNJD ka marrë disa ankesa në lidhje me pamundësinë e aplikimit online për ndihmë ekonomike apo përfitimin e skemave të tjera sociale nga ana e komunitetit Rom dhe Egjiptian, kjo si rezultat i mungesës së aftësive teknologjike si dhe pajisjeve kompjuterike/telefonike. Për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19, aplikimi për ndihmë ekonomike dhe skemat e tjera sociale, bëhet vetëm online. Kjo ka krijuar vështirësi dhe pabarazi në aksesin në shërbime nëpërmjet platformës shtetërore e-albania për anëtarët e komunitetit Rom dhe Egjiptian, të cilët nuk kanë njohuritë dhe teknologjinë e duhur për ta aksesuar, duke humbur kështu mundësinë e përfitimit nga e vetmja skemë ekonomike. Shërbimi online është i barabartë për të gjithë, por pamundësia e aksesimit të këtij shërbimi në thelb krijon situatë diskriminuese për këtë komunitet. Një problematikë tjetër e lidhur me aksesin në shërbime

<sup>1</sup> Kërkesë e protokolluar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me nr. 67, datë 12.01.2021.

*të komunitetit Rom dhe Egjiptian lidhet me pamundësinë e marrjes së kartonit si punëkërkuar i papunë. Vërtetimi i papunësisë është një dokument i domosdoshëm për të përfituar nga një sërë skemash të mbështetjes social-ekonomike, si: përfitimi i ndihmës ekonomike, programet sociale të strehimit, karta e shëndetit, kurset profesionale, etj. Mosdhënia e këtij dokumenti sipas kërkesës së individit (për ta përdorur aty ku i kërkohet) ka vënë në pozita të disfavorshme anëtarët e komunitetit Rom dhe Egjiptian, si kategori që qëzon mbrojtje të veçantë nga shteti. Për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19, aplikimi si punëkërkuar i papunë dhe marrja e vërtetimit të papunësisë bëhet vetëm online. Në thelb aplikimi vetëm “online” për përfitimin e shërbimeve si ndihma ekonomike, përfitimi i kartonit si punëkërkuar i papunë apo dhe skema të tjera sociale, përbën pengesë për përfitimin e këtyre shërbimeve dhe prek në mënyrë disproporcionale veçanarisht komunitetin Rom dhe Egjiptian, për vetë specifikat dhe vështirësitë social-ekonomike që ka ky komunitet, si pasojë e mungesës së aftësive teknologjike për të përdorur portalin e-albania, por dhe mungesës së mjeteve teknologjike si: kompjuter, laptop apo telefona. Për shkak të kësaj praktike që vështirëson aksesin në shërbime, një sërë familjesh të këtij komuniteti kanë humbur mundësinë për të aplikuar për përfitimin e ndihmës ekonomike apo kanë pasur vonesa në përfitimin e kartonit si punëkërkuar të papunë”.*

Qendra “Të drejtat e njeriut në demokraci”, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, shqyrtimin e problematikës me qëllim dhënien e mundësisë së aksesit në shërbime për komunitetin Rom dhe Egjiptian duke i ofruar/siguruar mundësi alternative për të aplikuar për përfitimin e shërbimeve sociale, duke shmangur në këtë mënyrë opsionin e vetëm që është forma e aplikimit online.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- Me shkresën nr. 158/1, datë 21.01.2021, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) dhe Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH), për çështjen e nisur kryesisht nga Komisioneri dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituar:
  - Informacion mbi mënyrën/at si bëhet aplikimi për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe për marrjen e vërtetimit të regjistrimit si punëkërkuar i papunë.
  - Cilat nga shërbimet, lidhur me programet e tjera të mbrojtjes sociale, ofrohet vetëm “online”.
  - A janë menduar forma të tjera të aplikimit për persona të cilët nuk kanë pajisje kompjuterike, akses në internet dhe nuk kanë aftësi teknologjike për të bërë aplikimin online.

- A ka pasur problematika lidhur me vështirësitë në kryerjen e aplikimit online nga persona të ndryshëm dhe në veçanti nga anëtarë të komunitetit Rom dhe Egjiptian dhe si janë zgjidhur ato.

Me shkresën nr. 139/1, datë 27.01.2021, Shërbimi Social Shtetëror në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “MSHMS ka nxjerrë Urdhrin nr. 213, datë 31.03.2020 “Për marrjen e masave për parandalimin e infektimit nga Covid-19 të aplikuesve për ndihmë ekonomike”. Në pikën 1 të këtij urdhri përcaktohet se, përjashtimisht, gjatë situatës së fatkeqësisë natyrore, aplikimet për ndihmën ekonomike sipas VKM-së nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, do të pranohen nga administratorët shoqëror të njësive administrative në formë elektronike ose përmes shërbimit postar. Gjithashtu, në pikën 5 të urdhrit të sipërcituar përcaktohet se: “Administratorët shoqëror të njësive administrative mbajnë kontakte në formë elektronike/telefonike me aplikuesit, për tu ardhur në ndihmë mbi mënyrën e plotësimit të aplikimit për përfitim të ndihmës ekonomike”. Për sa më sipër sqarojmë se, aplikimi në skemën e ndihmës ekonomike përgjatë periudhës së pandemisë të shkaktuar nga Covid-19, realizohej jo vetëm nëpërmjet platformës online por edhe përmes shërbimit postar të asistuar nga administratorët shoqëror, për tu siguruar aplikuesve mundësi alternative për aplikimin në skemën e ndihmës ekonomike. Me përfundimin e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, me datën 23.06.2020 sipas Vendimit të Kuvendit nr. 18, datë 23.04.2020, janë dhënë udhëzime në të gjitha bashkitë/njësitë administrative në mënyrë që aplikimet të realizohen pranë njësive ku ndodhet vendbanimi i tyre, duke respektuar të gjitha masat për parandalimin e përhapjes së infeksionit sipas protokollit të miratuar nga MSHMS-ja. Në Urdhrin e MSHMS-së nr. 213/1, datë 01.09.2020 “Për marrjen e masave të veçanta nga Njësitë e Vetqeverisjes Vendore për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19 për aplikuesit dhe përfituesit e ndihmës ekonomike”, në pikën 1 përcaktohet se, aplikimet për ndihmë ekonomike do të realizohen sipas përcaktimit në VKM-në nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, duke respektuar masat për parandalimin e përhapjes së infeksionit, sipas përcaktimeve në këtë urdhër. Për sa më sipër, bazuar në Ligjin nr. 57, datë 18.07.2019 “Për Asistencën në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM-në nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, në Kreun II përcaktohet procedura e aplikimit për përfitimin e ndihmës ekonomike. Familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme si dhe kategoritë e veçanta, mund të aplikojnë për përfitimin e ndihmës ekonomike pranë njësisë vendore ku kanë vendbanimin. Në pikën 1 të këtij kreu përcaktohet se, për të përfituar ndihmë ekonomike kryefamiljari/anëtari madhor, së bashku me bashkëshortin/en ose të vetëm kur nuk ka bashkëshort/e, nga data 1-10 të çdo muaji paraqiten pranë administratorit shoqëror të seksioneve të ndihmës dhe shërbimeve shoqërore në bashki/njësitë për të aplikuar për ndihmë ekonomike si familje në

nevojë me dokumentat e përcaktuara në aktet nënligjore. Lidhur me faktin nëse ka pasur problematika apo vështirësi në kryerjen e aplikimeve online nga persona të ndryshëm dhe në veçanti nga anëtarë të komunitetit Rom dhe Egjiptian sqarojmë se, pranë Drejtorisë së Përgjithëshme të SHSSH nuk kanë ardhur ankesa nga qytetarët për këtë problematikë. Gjithashtu bashkitë/njësitë administrative apo Drejtoritë Rajonale të SHSSH të cilët sipas legjislacionit në fuqi kanë kompetencë për shqyrtimin e ankesave, nuk kanë referuar problematika për këtë çështje”.

Me shkresën nr. 1362/1, datë 16.03.2021, Ministria e Financave dhe Ekonomisë në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA), nëpërmjet strukturave të saj, funksionon dhe rregullon veprimtarinë e saj në bazë të Ligjit nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”, Ligjit nr. 146/2015 “Për punëkërkuesit”, Ligjit nr. 66/2016 “Për shërbimet në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 837, datë 28.10.2020 “Për procedurat, kriteret e rregullat për ofrimin e shërbimeve të punësimit”. Për sa më sipër, procedurat dhe hapat që ndjek çdo zyrë punësimi janë në pritjen, trajtimin dhe dhënien e shërbimeve për të gjithë personat punëkërkues. Zyra përkatëse e punësimit vlerëson dhe regjistron çdo person që është në moshë për punë, që është i aftë dhe i gatshëm për punë, i cili deklaron se nuk është në marrëdhënie pune apo i vetëpunësuar dhe paraqitet personalisht, në zyrën e punësimit, me qëllim që të kërkojë punë. Punëkërkuesve, të cilët paraqiten në zyrën e punësimit për regjistrim, pas intervistimit dhe vlerësimit të karakteristikave profesionale e individuale, bazuar në vendet e lira që disponohen, u ofrohen mundësi pune të përshtatshme. Refuzimi i ofertës së punës së përshtatshme, qoftë edhe një herë, çon në shfuqizimin e statusit të punëkërkuesit dhe mospajisjen e tij me vërtetimin përkatës. Për sa më sipër, marrja e kartonit si punëkërkues i papunë, përfitohet pas regjistrimit dhe marrjes së statusit si punëkërkues i papunë, status i cili jepet pas vlerësimit nga ana e specialistit brenda afatit në zbatim të Nenit 4 të Ligjit 146/2015 “Për punëkërkuesit”. Pra, bëhet fjalë, në zbatim të legjislacionit në fuqi, për të gjithë individët që i drejtohen zyrës së punësimit, përfshirë edhe grupet e veçanta, ku futen edhe romët dhe egjiptianët, bazuar mbi parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit. Në bazë të këtij ligji, punëkërkuesit që përfitojnë ndihmë ekonomike janë të detyruar të paraqiten në zyrën e punësimit çdo muaj, për të kërkuar punë, apo sa herë që u kërkohet një gjë e tillë. Lidhur me shërbimet online, zbatohet bazën ligjore e cila lidhet me Urdhërin e Kryeministrit, nr. 158, datë 25.11.2019 “Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm online nga data 01.01.2020”. Pavarësisht, duke patur në konsideratë dhe në vëmendje të veçantë tipologjinë e punëkërkuesve dhe punëkërkuesve të papunë të regjistruar pranë zyrave tona të punësimit, zyrat përkatëse të punësimit, megjithë situatën e krijuar nga Covid-19 dhe gjatë gjithë periudhës së karantinës dhe në vazhdim, kanë ofruar për punëkërkuesit dhe punëkërkuesit e papunë të gjitha shërbimet e nevojshme dhe aplikimi on-line për këtë shërbim është opsional, në zbatim të Ligjit 15/2019 “Për Nxitjen e Punësimit”. Orientimi ka qenë që strukturat vendore të Punësimit të ofrojnë asistencën dhe ndihmesën e tyre kundrejt kësaj kategorie, në vështirësitë që do të hasnin në përfitimin e shërbimeve online

nëpërmjet një vendi të posaçëm të pajisur me lidhje interneti, për t'u përdorur nga kjo kategori e ndihmuar edhe nga specialistët tanë”.

Në përgjigje të shkresës së dërguar nga MSHMS, Qendra “Për të drejtat e njeriut në demokraci” me e-mail-in datë 04.02.2021, në mes të tjerash, ka informuar Komisionerin se: *“QDNJD ka konstatuar probleme në zbatimin në praktikë të këtyre akteve nënligjore. Megjithëse këto akte parashikojnë dhe forma alternative të aplikimit për përfitimin nga skemat e ndryshme shoqërore, ka pasur probleme me mënyrën e zbatimit të tyre në praktikë. Nga ankesat që QDNJD ka marrë në zyrë nga shtetas të komunitetit rom/egjiptian rezulton se forma e vetme e pranuar për aplikim nga ana e Njësive Administrative dhe Zyrave të Punës ka qënë ajo online, nëpërmjet portalit e-albania. Sa i përket kontaktit në formë telefonike/elektronikë që duhet të mbajnë administratorët shoqërorë të njësive administrative me aplikuesit për tu ardhur në ndihmë mbi mënyrën e plotësimit të aplikimit për përfitim të ndihmës ekonomike na rezulton se një komunikim i tillë për rastet e paraqitura në zyrë ka munguar. Por edhe nëse do të ishte kryer do të ishte i pamjaftueshëm për shkak të specifikës që ka ky komunitet sa i përket mungesës së aftësive teknologjike si dhe paisjeve kompjuterike/telefonike. Forma postare e dërgimit të dokumentacionit nuk është aplikuar në asnjë nga rastet që janë ankuar në zyrën tonë, pasi një mundësi e tillë alternative nuk ju është parashtruar aplikuesve. Për shkak të nivelit arsimor që ka ky komunitet në përgjithësi edhe forma postare e aplikimit pa asistencën e një punonjësi nuk është aspak efektive”.*

Me e-mail-in datë 17.03.2021, inspektori i çështjes ka kërkuar nga QDNJD-ja informacion të hollësishëm mbi raste konkrete të personave që janë asistuar nga qendra për aplikimin për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe të kartonit të vërtetimit të papunësisë.

Në përgjigje të kërkesës së institucionit të KMD-së, QDNJD-ja me e-mail-in datë 24.03.2021, në mes të tjerash, ka informuar Komisionerin se për arsye konfidencialiteti nuk e kanë të mundur për të vendosur në dispozicion të Komisionerit të dhënat e kërkuara.

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes, Komisioneri me shkresën nr. 158/4, datë 27.05.2021 njoftoi, MSHMS, MFE, SHSSH dhe QDNJD-në për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 04.06.2021, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e tyre dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe provat e palëve në proces.

Seanca u zhvillua në datë 04.06.2021, me praninë e palëve në proces: përfaqësueset e QDNJD-së, znj. L.C dhe znj. O.A dhe palëve të njoftuar për të marrë pjesë në seancë, përfaqësueses së MSHMS, znj. E.P, përfaqësueses së MFE, znj. G.P dhe përfaqësueses së SHSSH, znj. D.M.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësueset e QDNJD-së i qëndruan të njëjtave parashtime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor dhe me e-mail me KMD-në, si dhe deklaruan se: *“Komuniteti rom dhe egjiptian për arsye se nuk disponojnë mjete teknologjike si, kompiuter, laptop, dhe celular e kanë pasur të vështirë që të bënin aplikimet online, sidomos gjatë periudhës së karantinës. Qendra ka asistuar rreth 20 persona për të hapur një llogari në e-albania, që më pas të bënin aplikimin për përfitimin e ndihmës ekonomike. Këto persona nuk dëshirojnë të identifikohen në lidhje me këtë gjë, pasi janë përfitues të skemave të ndryshme sociale dhe nuk duan të përfshihen në çështje të tilla administrative, prandaj dhe refuzojnë të identifikohen. Personat e komunitetit rom dhe egjiptian nuk kanë qenë të informuar se mund të aplikojnë dhe me postë dhe vështirësitë e këtyre personave kanë ndodhur në periudhën qershor-korrik, kryesisht në Njësinë Administrative nr. 6, në Tiranë”*.

Gjatë seancës dëgjimore përfaqësuesja e MFE-së, i qëndroi të njëjtave parashtime që kishte bërë të njohur gjatë komunikimit shkresor me KMD-në, si dhe deklaroi se: *“Gjatë periudhës së karantinës dhe më pas, të gjitha zyrat e punës kanë qenë të hapura për të kryer shërbimet bazë si, rregjistrimi i punëkërkuarve të papunë dhe ka pasur punonjës të veçantë që asistojnë persona të ndryshëm që kishin nevojë për ndihmë. Pas karantinës ka pasur një fluks të madh aplikimesh në zyrat e punës për arsye se ka pasur një dyfishim të pagesës së papunësisë, të ndihmës ekonomike dhe përfitimi i pagës së luftës, për periudhën mars-qershor dhe të gjithë përfituesit kanë qenë aktiv. Gjatë periudhës së karantinës dhe më pas ka pasur një rritje me 29% të aplikuesve të komunitetit rom dhe një rritje me 20% të aplikuesve nga komuniteti egjiptian. Në të gjithë Shqipërinë numri i punëkërkuarve të rregjistruar është rritur me 30.000 mijë persona”*.

Gjatë seancës dëgjimore përfaqësuesja e MSHMS-së, i qëndroi të njëjtave parashtime që kishte bërë të njohur gjatë komunikimit shkresor me KMD-në, si dhe deklaroi se: *“Gjatë periudhës së karantinës personat ekzistues që përfitonin ndihmën ekonomike nuk kanë pasur nevojë që të paraqiteshin/aplikojnë tek administratori shoqëror pranë bashkive, ndërsa për personat e rinj që donin të aplikojnë për të përfituar ndihmën ekonomike, ato paraqiteshin tek administratori shoqëror të cilët gjatë gjithë periudhës kanë qenë në zyrë dhe kanë asistuar njerëzit. Gjatë kësaj periudhe kemi rritje të përfituesve në skemë me 200-300 familje në muaj, gjë që tregon se skema ka funksionuar, njerëzit kanë aplikuar dhe nuk kemi pasur asnjë ankesë. MSHMS-ja ka trajtuar në mënyrë të barabartë si familjet e komunitetit rom dhe egjiptian ashtu dhe kategoritë e tjera të familjeve në nevojë si, familjet që kanë në përbërje persona me aftësi të kufizuara dhe familje që nuk i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian por janë në kushte të vështira ekonomike dhe nuk kanë kompiuter dhe celular dhe nuk kanë akses në mjetet teknologjike. Pavarësisht se Urdhëri nr. 213/1 ka dalë në datë 1 shtator, nga ana e MSHMS-së është dhënë udhëzimi që në fillim të muajit korrik që aplikimet të bëheshin dhe në qendrat ku qytetarët kanë vendbanimin. Gjatë muajve të karantinës numri i përfituesve të ndihmës ekonomike nuk ka ndryshuar pasi asnjë familje nuk është penalizuar për arsye të masave anticovid, ndërkohë që numri i familjeve përfituese të komunitetit rom dhe egjiptian është rritur nga 2749 përfitues në muajin mars, në 3418 familje në muajin qershor, gjë që tregon se skema ka funksionuar. Përfituesit e ndihmës ekonomike e*

*tërheqin masën e ndihmës pranë zyrave të postës, që do të thotë se aplikuesit nuk kanë vështirësi që ti drejtohen postës për kryerjen e shërbimeve”.*

Në vijim të seancës dëgjimore, përfaqësuesja e MFE-së me e-mail-in datë 15.06.2021, ka dërguar shpjegime dhe informacion, ku ndër të tjera informon se: *“Lidhur me shërbimet online, AKPA zbaton bazën ligjore, e cila lidhet me Urdhërin e Kryeministrit, nr. 158, datë 25.11.2019 “Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm online nga data 01.01.2020”.*

*Pavarësisht, duke patur në konsideratë dhe në vëmendje të veçantë tipologjinë e punëkërkesve dhe punëkërkesve të papunë të regjistruar pranë zyrave të punësimit, zyrat përkatëse megjithë situatën e krijuar nga Covid-19 dhe gjatë gjithë periudhës së karantinës dhe në vazhdim, kanë ofruar për punëkërkesit dhe punëkërkesit e papunë të gjitha shërbimet e nevojshme dhe aplikimi online për këtë shërbim është opsional, në zbatim të Ligjit 15/2019 “Për Nxitjen e Punësimit”.*

*Orientimi ka qënë që strukturat vendore të punësimit të ofrojnë asistencën dhe ndihmesën e tyre kundrejt kësaj kategorie në vështirësitë që do të hasnin në përfitimin e shërbimeve online nëpërmjet një vendi të posaçëm i pajisur me lidhje interneti për t’u përdorur nga kjo kategori e ndihmuar edhe nga specialistët tanë.*

*Në vitin 2020 në Zyrat e Punës rezultonin të regjistruar 3,394 punëkërkes të papunë nga kategoria romë dhe 4,176 nga kategoria egjiptianë. Krahasuar me stokun e vitit 2019, numri i punëkërkesve të regjistruar nga kategoria romë është rritur me 29%, dhe nga kategoria egjiptian është rritur me 20%”.*

Në vijim të seancës dëgjimore, përfaqësuesja e SHSSH me e-mail-in datë 24.06.2021, ka dërguar shpjegime dhe informacion, ku ndër të tjera informon se: *“Referuar statistikave mbi numrin e aplikuesve që janë anëtarë të komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë Tiranë rezulton se, gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga Covid-19, për muajin Prill-Qershor 2020, evidentohet një rritje e numrit të aplikuesve të komunitetit Rom dhe Egjiptian në skemën e ndihmës ekonomike.*

*Në lidhje me statistikën mbi numrin e personave që kanë aplikuar në skemën e ndihmës ekonomike online dhe atyre që kanë aplikuar me postë, për periudhën Mars 2020 - Shkurt 2021 ju bëjmë me dije se, këto të dhëna nuk disponohen nga ana jonë.*

*Nga të dhënat e marra nga Regjistri Elektronik Kombëtar i ndihmës ekonomike rezulton se, numri i aplikuesve të ndihmës ekonomike anëtar të komunitetit Rom dhe Egjiptian ka qënë në rritje, veçanërisht gjatë periudhës së pandemisë Covid-19. Kjo rritje e numrit të aplikuesve të ndihmës ekonomike që i përkasin komunitetit Rom dhe Egjiptian tregon automatikisht efektivitetin e funksionimit të sistemit të aplikimit online apo me postë. Kjo rritje e numrit të aplikuesve i referohet vetëm hyrjeve të reja (të cilat kryheshin online apo me postë).*

Ky përjashtim nga procedura e aplikimit për ndihmë ekonomike e përcaktuar në VKM-në nr. 597, datë 05.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, sipas së cilit aplikimet për ndihmë ekonomike do të pranoreshin nga administratorët shoqëror në formë elektronike ose përmes shërbimit postar, i referohet vetëm periudhës së fatkeqësisë natyrore, sipas Urdhrit të MSHMS-së, nr. 213, datë 31.03.2020 “Për marrjen e masave për parandalimin e infektimit nga Covid-19 të aplikuesve për ndihmë ekonomike”, pika 1. Me përfundimin e gjëndjes së fatkeqësisë natyrore, më datë 23.06.2020 sipas VKM-së nr. 8, datë 23.04.2020, nga ana e SHSSH janë dhënë udhëzimet përkatëse me email<sup>2</sup> (e gjeni bashkëlidhur), në mënyrë që aplikimet për ndihmë ekonomike të kryhen pranë njësive ku aplikuesit kanë vendbanimin e tyre, duke respektuar të gjitha masat për parandalimin e përhapjes së Covid-19.

Për sa më sipër, me përfundimin e gjëndjes së fatkeqësisë natyrore, që prej muajit Korrik 2020 deri në daljen e Urdhrit të MSHMS-së Nr. 213/1, datë 01.09.2020 “Për marrjen e masave të veçanta nga Njësitë e Vetqeverisjes Vendore për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19 për aplikuesit dhe përfituesit e ndihmës ekonomike” e cila shfuqizoi Urdhrin nr. 213/2020, aplikimet për ndihmën ekonomike u kryen sipas VKM-së nr. 597/2019 nga data 1-10 Korrik pranë njësive administrative ku aplikuesit kanë vendbanimin e tyre, ndërsa për deklaratimet 3 mujore sistemi qëndroi i hapur nga 1-20 korrik. Pra sqarojmë se, periudha e aplikimit online apo me postë ka qenë vetëm 3 muaj, Prill-Qershor 2020, sistuatë kjo e imponuar nga pandemia Covid-19 në kuadër të mbrojtjes së një të drejte madhore siç është e drejta e jetës dhe shëndetit, një e drejtë kjo nga e cila derivojnë të drejtat e tjera si dhe pa mohuar të drejtën e qytetarëve për të përfituar ndihmë ekonomike.

Në lidhje me njoftimin e aplikuesve të ndihmës ekonomike për mundësinë e aplikimit online apo përmes shërbimit postar, sqarojmë se gjatë periudhës së pandemisë Covid-19, administratorët shoqëror kanë vazhduar punën në institucion dhe në terren përmes shpërndarjes së pakove ushqimore për kategoritë në nevojë (kjo do të thotë që kontakti dhe mundësia e informimit administrator-qytetar ka vazhduar). Për çdo paqartësi apo informacion nga ana e qytetarëve, administratorët shoqëror të njësive administrative kanë mbajtur kontakte në formë elektronike/telefonike me aplikuesit, për tu ardhur në ndihmë mbi mënyrën e plotësimit të aplikimit për përfitim të ndihmës ekonomike. Gjithashtu në faqen zyrtare të Shërbimit Social Shtetëror [www.sherbimisocial.gov.al](http://www.sherbimisocial.gov.al) është dhënë informacioni përkatës bashkë me kontaktet e administratorëve shoqëror. Bazuar edhe në argumentat e dhëna nga përfaqësues të Qëndës “Të drejtat e njeriut në demokraci”, në seancën dëgjimore të datës 04.06.2002<sup>1</sup>, arsyetohet se aplikuesit janë rekomanduar nga administratorët për mënyrën e aplikimit.

<sup>2</sup> Referuar e-mail-it datë 09.07.2020 të dërguar nga Drejtorja e Drejtorisë së Kontrollit të Pagesës së NE&PAK: “Ju njoftoj se aplikimet për ndihmën ekonomike do të jenë sipas VKM nr. 597, deri me datë 10 korrik. Ndërsa lidhur me deklaratimet 3 mujore, për shkak të numrit të lartë të familjeve/individëve në nevojë dhe për ti dhënë kohë gjithë procedurës, sistemi do të qëndrojë i hapur vetëm për deklaratimet 3 mujore deri me datë 20 korrik. Bashkitë/njësitë administrative për të mos krijuar grumbullime në njësitë vendore, mund ta menaxhojnë situatën duke shkuar edhe pranë vendbanimit të familjeve (jashtë banesës) në mënyrë që të gjithë anëtarët madhorë të kenë mundësi të firmosin”.

*Për sa më sipër, referuar të dhënave të marra nga Regjistri Elektronik Kombëtar rezulton të ketë një rritje të numrit të aplikuesve të ndihmës ekonomike anëtar të komunitetit Rom dhe Egjiptian gjatë periudhës së pandemisë Covid-19, e cila i atribuohet hyrjeve të reja (të cilat në këtë periudhë i referohen aplikimeve online apo me postë). Nga ana tjetër sqarojmë se, pranë Drejtorisë së Përgjithëshme të Shërbimit Social Shtetëror nuk kanë ardhur ankesa nga qytetarët për këtë problematikë si dhe bashkitë/njësitë administrative apo Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror të cilët sipas legjislacionit në fuqi kanë kompetencë për shqyrtimin e ankesave”.*

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm.**

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10021/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Mbrojtja e shtresave në nevojë dhe gëzimi i të drejtave të tyre në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim garantohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Neni 18 i Kushtetutës së RSH-së sanksionon se të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. Kreu i IV i Kushtetutës vë theksin tek liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, të cilat duhet të gëzohen de facto, në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim.

Gjendja e vështirë e komunitetit rom dhe egjiptian njihet dhe nga qeveria e Republikës së Shqipërisë e cila me VKM nr.1072, datë 23.12.2015 ka miratuar “Planin Kombëtar të veprimit për integrimin e romëve dhe egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë, 2016-2020” në të cilën shkruhet: “*Romët dhe egjiptianët përballen me barriera të drejtpërdrejta dhe të tërthorta në aksesin e shërbimeve publike, të cilat lindin nga kriteret e pranueshmërisë që ata nuk mund t'i plotësojnë, nga mungesa e informacionit ose nga moskuptimi i procedurave administrative, si dhe nga stigmatizimi dhe diskriminimi i vazhdueshëm nga pjesa tjetër e popullatës. Përfundimi afatgjatë ka ndikuar në kushtet e jetesës së romëve dhe egjiptianëve, në trajtimin nga pjesa tjetër e popullatës dhe në marrëdhënien me institucionet shtetërore. Studimet tregojnë se niveli i varfërisë në radhët e komunitetit rom është dy herë më i lartë se në pjesën tjetër të popullatës, ndërsa niveli i papunësisë është tre herë më i lartë se mesatarja. Për shkak të periudhave të gjata të papunësisë dhe angazhimit të shpeshtë në punë informale dhe me pagë të ulët, familjet rome preken nga varfëria mbi dy herë më shumë sesa familjet jo-rome që jetojnë në afërsi të tyre.*

*Romët që arrijnë të gjejnë punë merren kryesisht me tregti të vogla të dorës së dytë dhe mbledhjen e mbetjeve të riciklueshme<sup>3</sup>”.*

Pretendimi i QDNJD, konsiston në faktin e pamundësisë së aplikimit online për ndihmë ekonomike dhe pagesës së papunësisë nga ana e komunitetit Rom dhe Egjiptian, si rezultat i mungesës së aftësive teknologjike si dhe pajisjeve kompjuterike/telefonike, gjatë periudhës së krijuar nga Covid-19.

Në kuadër të trajtimit të pretendimit të mësipërm, Komisioneri analizoi legjislacionin përkatës, me qëllim që të evidentohet nëse është cënuar kategoria e personave që janë anëtarë të komunitetit rom dhe egjiptian për të aplikuar online, për të përfituar ndihmën ekonomike dhe pagesës së papunësisë, gjatë periudhës së shpallur të gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

Këshilli i Ministrave me Aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, vendosi marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19.

Në pikën 4, të VKM-së nr. 236, datë 19.03.2020 “Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”, janë parashikuar se kush do të konsiderohen si shtresa në nevojë, dhe përcaktohet se:

*Në kuptim të këtij vendimi, shtresa në nevojë do të konsiderohen:*

*a) personat/familjet, të cilët nuk kanë familjarë të aftë për punë në njësinë administrative ku jetojnë, dhe që bëjnë pjesë në grupet, si më poshtë vijon:*

*i. Familjet/individët në nevojë, përfitues të ndihmës ekonomike;*

*ii. Personat me aftësi të kufizuara;*

*iii. Personat, të cilët përfitojnë pension pleqërie.*

*b) personat, të cilët, pavarësisht përbërjes familjare dhe vendndodhjes së saj, bëjnë pjesë në grupet, si më poshtë vijon:*

*i. Familjet/individët në nevojë, të cilët janë të pastrehë;*

*ii. Familjet që kanë humbur banesën për shkak të tërmetit.*

Në pikën 9 të këtij vendimi është përcaktuar se: “Dërgimi i pagesave mujore, që këta persona përfitojnë nga programi i mbrojtjes sociale, i sigurimeve shoqërore, në banesë, do të kryhet nga shërbimi postar, në bazë të listave të konfirmuara, sipas përcaktimeve të këtij vendimi”.

Ky akt nënligjor është një masë e ndërmarrë nga qeveria e Republikës së Shqipërisë lidhur me situatën e krijuar në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga virusi COVID-19 për përmbushjen e detyrimeve nga ana e shtetit për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve infektive, si dhe masat që duhet të marrin strukturat shtetërore për ofrimin e asistencës për shtresat në nevojë.

<sup>3</sup> Statistikat për komunitetin rom dhe egjiptianët i referohen: “Planit kombëtar të veprimit për integrimin e romëve dhe egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë, 2016-2020” miratuar me VKM nr.1072, datë 23.12.2015, fq. 4, 11 dhe 12.

Me Vendimin nr. 243, datë 24.03.2020, Këshilli i Ministrave shpalli gjendjen e fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë për shkak të epidemisë së shkaktuar nga Covid-19.

Këshilli i Ministrave me Vendimin nr. 254, datë 27.3.2020, “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 milionë lekë, ndihmës ekonomike e të pagesës të së ardhurës nga papunësia gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, të shpallur si pasojë e Covid-19”, vendosi në mes të tjerash dhe dhënien e një pagese shtesë për individët që përfitojnë pagesë të ndihmës ekonomike dhe nga papunësia, për një periudhë jo më shumë se 3 muaj.

Kështu në Kreun IV, pika 2 dhe 3 vendosi:

*“2. Pagesa e ndihmës ekonomike për subjektet përfituese, sipas Vendimit nr. 597, datë 4.9.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, që rezultojnë përfitues të ndihmës ekonomike ose kanë aplikuar për të përpara datës 10 mars, do të jetë sa dyfishi i shumës së llogaritur sipas vendimit të sipërpërmendur.*

*3. Pagesa e së ardhurës nga papunësia për subjektet përfituese sipas vendimit nr.161, datë 21.3.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për pagesën e së ardhurës nga papunësia”, që rezultojnë përfitues të pagesës të së ardhurës nga papunësia ose kanë aplikuar për të përpara datës 10 mars 2020, do të jetë sa dyfishi i shumës së llogaritur sipas vendimit të sipërpërmendur”.*

MSHMS-së, me Urdhërin nr. 213, datë 31.03.2020 “Për marrjen e masave për parandalimin e infektimit nga Covid-19 të aplikuesve për ndihmë ekonomike”, urdhëroi se:

- 1. “Përjashtimisht, gjatë situatës së fatkeqësisë natyrore, aplikimet për ndihmën ekonomike sipas VKM-së nr. 597, datë 04.09.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, do të pranohen nga administratorët shoqëror të njësive administrative në formë elektronike ose përmes shërbimit postar.*
- 2. Deklarimet tre mujore të përfituesve të ndihmës ekonomike do të kryhen pas përfundimit të situatës së fatkesësisë natyrore të shpallur për shkak të Covid-19.*
- 5. Administratorët shoqëror të njësive administrative mbajnë kontakte në formë elektronike/telefonike me aplikuesit, për t’u ardhur në ndihmë mbi mënyrën e plotësimit të aplikimit për përfitim të ndihmës ekonomike”.*

MFE me Urdhërin nr. 87, datë 02.04.2020 “Për mënyrën e procedimit të ofrimit të shërbimeve të punësimit dhe të pagesës së papunësisë gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga Covid-19”, urdhëroi se:

1. “Të gjitha shërbimet e punësimit, do të ofrohen nëpërmjet komunikimit në distancë (e-albania, postë elektronike apo postë) për të lehtësuar komunikimin me strukturat e AKPA-së, si dhe për të mbrojtur jetën e qytetarëve dhe të stafit nga infektimi, si pasojë e epidemisë së shkaktuar nga Covid-19.
2. Përfundimisht, gjatë periudhës së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, të shpallur për shkak të epidemisë, të gjithë punëkërkuarët e papunë që kanë qenë të regjistruar deri në datën 10 mars dhe që janë aktualisht përfitues të pagesës së papunësisë, nuk do të paraqiten në sportelet e zyrës së punësimit, por këto shërbime do t’ju ofrohen nëpërmjet komunikimit në distancë (e-albania, postë elektronike apo me postë) nga zyrat përkatëse.
5. Përfundimisht, gjatë periudhës së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, të shpallur për shkak të epidemisë, të gjithë personat që do të marrin vërtetim si punëkërkuar të papunë apo që duhet të paraqiten pranë zyrave të punës çdo muaj, nuk do të paraqiten pranë tyre por AKPA-ja do të konfirmojë elektronikisht listat e fondit 6% me bashkitë dhe përmes sistemeve të menaxhimit të informacionit listat me SHSSH”.

Me Vendimin nr. 18, datë 23.04.2020, “Për dhënien e pëlqimit për zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, Kuvendi i Shqipërisë vendosi: “I. Dhënien e pëlqimit për zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, të shpallur me VKM nr. 243, datë 24.03.2020, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, deri në datë 23.06.2020”.

MSHMS-së, me Urdhërin nr. 213/1, datë 01.09.2020 “Për marrjen e masave të veçanta nga njësitë e vetqeverisjes vendore për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19 për aplikuesit dhe përfituesit e ndihmës ekonomike”, urdhëroi se:

1. “Aplikimet për ndihmë ekonomike do të realizohen sipas përcaktimit në VKM nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” duke respektuar masat për parandalimin e përhapjes së infeksionit, sipas përcaktimeve në këtë urdhër”.
12. Urdhri nr. 213, datë 31.03.2020, shfuqizohet”.

Rregullat, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse për përfitimin e asistencës sociale, përcaktohen nga Ligji nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 57/2019).

Kështu në ligjin nr. 57/2019 është përcaktuar se:

## **Neni 2**

### **Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim:

a) të përcaktojë ndihmën ekonomike dhe përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar për individët dhe familjet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike,

zhvillimin e aftësive e të mundësive personale, ruajtjen e integritetit dhe përfshirjen shoqërore për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore;

b) të zbusë varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët e familjet, si dhe të krijojnë mundësi për integrimin e tyre, nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrjesh e shërbimesh për përmirësimin e jetesës së tyre;

## **Neni 7**

### **Përfituesit e ndihmës ekonomike**

Përfituesit e ndihmës ekonomike janë:

a) familjet në nevojë, që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme;

b) jetimët, të cilët nuk janë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;

c) prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë;

ç) viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore, deri në çastin e punësimit të tyre;

d) viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrin të mbrojtjes ose urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, që nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore.

## **Neni 12**

### **Pagesa e ndihmës ekonomike**

1. Ndihma ekonomike është një pagesë që jepet në formën e një shpërblimi mujor në lekë, për kategoritë e përcaktuara në nenin 7, të këtij ligji. Kufizimi në kohë i ndihmës ekonomike bëhet sipas përcaktimeve me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Ndihma ekonomike, që përfitojnë familjet dhe individët në nevojë, është e plotë dhe masa nuk kufizohet për shkak të numrit të anëtarëve. Ndihmë ekonomike përfitojnë familjet që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme nga programet e mbrojtjes shoqërore, remitancat, qiraja, asetet, bujqësia apo të ardhura të tjera, dhe individët e përcaktuar në nenin 7, të këtij ligji.

## **Neni 16**

### **Aplikimi dhe përfitimi i ndihmës ekonomike**

1. Kërkesa për të përfituar ndihmë ekonomike bëhet nga:

a) kryetari i familjes ose njëri nga anëtarët madhorë të familjes, së bashku me bashkëshortin/en ose i vetëm, kur nuk ka bashkëshort/e;

b) secili prej bashkëshortëve, në rastet kur ata janë në proces zgjidhjeje martese dhe nuk ka ende vendim gjykatë të formës së prerë;

c) nga vetë individi, sipas përcaktimeve në shkronjat “b”, “ç” e “d”, të nenit 7.

2. Aplikimi për të përfituar ndihmë ekonomike bëhet tek administratori shoqëror në njësinë administrative, nën juridiksionin e së cilës ka vendbanimin. Kriteret, procedura dhe

dokumentacioni për përfitimin e ndihmës ekonomike, si dhe masa e përfitimit të saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Ndihma ekonomike shpërndahet një herë në muaj nga bashkia nëpërmjet shërbimit bankar dhe/ose shërbimit postar, bazuar në vendimin e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

## **Neni 23**

### **Roli i administratorit shoqëror të njësisë administrative**

Administratorët shoqërorë në njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë:

a) të identifikojnë familjet dhe individët në nevojë dhe t'i ftojnë e t'i informojnë për aplikim për ndihmë ekonomike;

b) të plotësojnë aplikimin për familjet dhe individët në nevojë në Regjistrin Elektronik Kombëtar;

.....

i) të informojnë dhe të udhëzojnë komunitetet lidhur me skemën e ndihmës ekonomike dhe pagesën e aftësisë së kufizuar, me anë të fushatave të ndryshme informuese;

Procedura dhe dokumentacioni i përfitimit të ndihmës ekonomike rregullohet sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 597, datë 04.09.2019 *“Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”* (në vijim VKM nr. 597/2019).

Kështu në VKM-në nr. 597/2019 është përcaktuar se:

## **Kreu I**

### **Subjektet, Kriteret dhe Dokumentacioni për Përfitimin e Ndihmës Ekonomike**

2. Përfituesit e ndihmës ekonomike janë:

a) familjet në nevojë, që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme;

b) jetimët, të cilët nuk janë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;

c) prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë;

ç) viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore, deri në çastin e punësimit të tyre;

d) viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrin të mbrojtjes ose urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, që nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore.

## **Kreu II**

### **Procedura e aplikimit për përfitimin e ndihmës ekonomike**

1. Administratori shoqëror identifikon familjet dhe individët në nevojë, i informon ata mbi procedurat e aplikimit dhe të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe i fton ata për aplikim. Administratori shoqëror, në prani të kryetarit të familjes/anëtarit madhor, së bashku me bashkëshortin/en, ose të vetëm kur nuk ka bashkëshort/e, kur aplikon për ndihmë ekonomike, hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar, brenda 10 (dhjetë) ditëve të para të muajit të dhënat e mëposhtme:

Pra, referuar legjislacionit të sipërcituar, rezulton se nga data 01.04.2020, të gjithë familjet dhe individët që përfitojnë ndihmën ekonomike dhe pagesë papunësie ose që kanë aplikuar përpara datës 10 mars, do të përfitojnë dyfishin e pagesës së ndihmës ekonomike dhe të papunësisë pa pasur nevojë që të paraqiten për të kryer aplikimin për përfitimin e kësaj pagese, ndërsa personat që do të aplikojnë për herë të parë për ndihmë ekonomike, duhet ta bëjnë atë në formë elektronike ose përmes shërbimit postar.

Në këtë proces administratorët shoqërorë të njësive administrative kanë qenë përgjegjës për kryerjen e aplikimeve për ndihmë ekonomike, duke mundur ata vetë kontaktin elektronik ose me telefon, për t'iu ardhur në ndihmë të gjithë aplikuesve për përfitimin e ndihmës ekonomike.

Referuar legjislacionit të sipërcituar, pagesën e ndihmës ekonomike mund ta përfitojnë familjet në nevojë, që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme, jetimët, të cilët nuk janë në institucionet e përkujdesjes shoqërore, prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë, viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore, deri në çastin e punësimit të tyre dhe viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, që nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore.

Pra, përfitimin e pagesës së ndihmës ekonomike nuk e përfitojnë vetëm kategoria e personave që janë të komunitetit rom dhe egjiptian por e përfitojë dhe kategori të tjera që janë në gjendje ekonomike dhe sociale në kushte të njëjta me personat e komunitetit rom dhe egjiptian.

Pavarësisht se formulari përkatës, që duhet të plotësohet për përfitimin e ndihmës ekonomike plotësohet online ose me postë, duhet theksuar fakti se jo të gjithë individët mund të kenë njohuritë dhe të kenë akses për të bërë këtë aplikim. Shumë familje që kanë të drejtë për të aplikuar për ndihmë ekonomike, përfshirë anëtarët e komunitetit rom dhe egjiptian, kanë mundësi të kufizuara për të aplikuar, pasi ose nuk kanë në përdorim mjete elektronike apo celularë, ose nuk kanë njohuritë e duhura për të kryer këtë aplikim.

Referuar legjislacionit të sipërcituar por dhe shkresave të dërguara nga institucionet, rezulton se çdo institucion përgjegjës për ofrimin e shërbimit të aplikimit online për ndihmën ekonomike dhe të pagesës së papunësisë ka pasur në dispozicion të aplikuesve administratorin shoqëror dhe zyrtarë e punës kanë parashikuar vendosjen e një specialisti dhe një vend të posaçëm të pajisur me

lidhje interneti për t'u përdorur nga aplikuesit që do të kishin vështirësi për të siguruar në mënyrë të pavarur shërbimet online.

Por gjatë shqyrtimit të çështjes, rezultoi e provuar si nga deklaratimet e përfaqësuesve të MSHMS, MFE dhe SHSSH, por dhe nga QDNJD se nuk ka pasur asnjë ankesë nga persona të ndryshëm, përfshirë anëtarët e komunitetit rom dhe egjiptian, për pamundësinë e aplikimit dhe përfitimit të ndihmës ekonomike për shkak se nuk kishin të mundur të aplikonin online apo administratori shoqëror i kishte mohuar ndihmën për të aplikuar për përfitimin e ndihmës ekonomike.

QDNJD nuk ka sjellë ndonjë provë që të vërtetojë faktin se persona të komunitetit rom dhe egjiptian apo dhe persona nga kategori të tjera që përfitojnë ndihmën ekonomike, iu është mohuar nga personat përgjegjës apo institucionet, mundësia për të aplikuar online për përfitimin e pagesës së ndihmës ekonomike dhe të papunësisë. Jo domosdoshmërisht, fakti që 20 persona janë asistuar nga QDNJD, për të bërë aplikimin online gjatë periudhës së pandemisë, për një shërbim të cilin e përfitonin nga administratori shoqëror ose me postë, të çon në provimin apo marrjen si të mirëqenë të deklaratimit të qendrës se ky shërbim i është mohuar nga institucionet shërbimofruese dhe personat kanë humbur të drejtën e përfitimit nga skemat e mbrojtjes sociale.

Komisioneri vlerëson se, ndodhemi në kushtet kur pretendimi i QDNJD është i karakterit deklarativ dhe nuk rezulton i provuar në ndonjë provë, akt apo rrethanë tjetër dëshmuuese.

Nga ana tjetër, referuar të dhënave të dërguara nga SHSSH për aplikuesit që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian gjatë periudhës mars-gusht 2020, rezulton se:

- Në Bashkinë Tiranë në muajin mars kanë aplikuar 261 persona, ndërsa në muajin gusht kanë aplikuar 293 persona.
- Në të gjitha bashkitë numri total i aplikuesve në muajin mars ka qenë 2953 persona, ndërsa në muajin gusht kanë aplikuar 3432 persona.

Gjithashtu, referuar të dhënave të dërguara nga MFE, rezulton se gjatë vitit 2020, numri i punëkërkuesve të papunë të regjistruar në zyrat e punës nga kategoria romë është rritur me 29%, ndërsa nga kategoria egjiptian është rritur me 20%.

Referuar të dhënave më sipër, rezulton se numri i personave të komunitetit rom dhe egjiptian që kanë aplikuar për të përfituar pagesën e ndihmës ekonomike dhe të papunësisë, gjatë periudhës së masave kufizuese ka qenë më i madh sesa përpara vendosjes së masave kufizuese, gjë të tregon se anëtarët e komunitetit rom dhe egjiptian nuk kanë pasur kufizime për të përfituar ndihmën ekonomike dhe pagesën e papunësisë gjatë kësaj periudhe.

Për rrjedhojë, Komisioneri vëren se, informacioni i dërguar nga QDNJD për pamundësinë e aplikimit online për pagesën e ndihmës ekonomike dhe të papunësisë nga ana e komunitetit Rom dhe Egjiptian, si rezultat i mungesës së aftësive teknologjike si dhe pajisjeve kompjuterike/telefonike, gjatë periudhës së krijuar nga COVID-19, nuk rezulton i provuar.

Në analizë të sa më sipër, Komisioneri vlerëson se aplikuesit anëtarë të komunitetit rom dhe egjiptian nuk janë ekspozuar ndaj një qendrimi të padrejtë e disfavorizues nga ana e MSHMS-së dhe MFE-së.

Në këtë kuptim dhe në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221/04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se aplikuesit anëtarë të komunitetit rom dhe egjiptian nuk i janë nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e MSHMS-së dhe MFE-së.

Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e MSHMS-së dhe MFE-së, për shkak të racës.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 7, pika 3, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma c), nenin 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të aplikuesve për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe të pagesës së papunësisë, anëtarë të komunitetit rom dhe egjiptian, gjatë periudhës së kufizimeve për shkak të fatkeqësisë natyrore, nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**